

LULJETA BORA – BEJLERI

**“PSE POETËT NUK E SHKRUAJNË MË POEMËN?”,
ASPEKTE QË KANË TË BËJNË ME LËVRIMIN E POEMËS
SË VITEVE '80, NË LETËRSINË SHQIPE.**

Pse poetët nuk e shkruajnë më poemën? Aspekte që kanë të bëjnë me lëvrimin e poemës së viteve '80, në letërsinë shqipe.

Poezia e viteve '60, ashtu sikurse poezia e pasluftës, vijoi me tonet madhore. Mes këtyre toneve të shkruara edhe tek temat nga realiteti (por duke iu larguar gjithnjë e më shumë moralizimeve politike), poetët e viteve '60 mbetën parapëlqyes të *pamjeve në blloqe të mëdha* të cilat i dhanë mes poemës, gjini që u kristalizua në këto vite duke u modeluar (siç është përcaktuar nga studiuesit) edhe sipas futurizmit (parimet), komunizmit në përmbajtje dhe traditës në vargëzim. Poema e Kadaresë me tematikën industriale dhe fjalorin teknik, poema e Agollit me tonet intime të njeriut të tokës, dhe poema e Arapit me tonet e matura medituese, ishin njëherësh kulminacionet e këtij lloji poetik në këto vite, si për tematikat ashtu edhe për procedimet teknike të vargëzimit. Por, me kalimin e viteve ky model poeme mori formën e një tradite të pa kapërcyeshme, duke u bërë pengesë për poezinë në vazhdim¹.

Poetët që erdhën më vonë, në vitet '70, synuan ta bëjnë poezinë më personale, shoqëruar kjo edhe me kërkime në formë. Ata u përpoqën të depërtojnë në pamjet nga realiteti dhe sidomos në fijet të imta të shpirtit duke projektuar njëherësh nevojën e thellimit në botën e njeriut me shqetësime të kohës; në specifika të botës së ndërtuesit, minatorit, bujkut, gjë që u pa qartë sidomos tek poeti Xh.

¹ Shih për më tepër Sh. Sinani, *Njerëzit e krisur të D. Agollit*, f. 34, *Brezi i viteve '60 e dominoi letërsinë shqipe për më shumë se një çerek shekulli, deri sa, sidomos në poezi, me arkitekturën e veta të kthyer në gjedhe krijuese, gati-gati në modele të imitueshme, sidomos me poemën, u bë pengesë për zhvillime më të përparura, deri në atë shkallë sa vijuesit e traditës së tyre (K. Petriri etj) pësuan dështim.*

Spahiu e M. Zeqo. *Tek unë lëvizin peizazhet, lëviz atdheu, / udhët mbledhen si cepa yjesh viganë / Plot antena / qytetesh, grurë dhe këngë / Në çdo qelizën time jeton një njeri / Unë jam i shumfishuar në hapësirë dhe në kohë / Tek të gjithë të dashurit e mi*²

Si lloj letrar, poema, (në formën klasike të saj) s'është gjë tjetër veçse një tregim në vargje ku flitet për ngjarje dhe ndjenja të shprehura mes digresionit lirik dhe koloritit emocional. Përmbajtja dhe forma e saj ka ndryshuar në varësi nga ndryshimet historike³. Kështu, që nga mesi i viteve '70, tema epike dhe tema e madhe po mjegullohej dhe poemën po e zëvendësonte poezia qytetare, ku figurat dhe idetë lidheshin drejtpërdrejt me jetën e përditshme. Poetët po kuptonin se poezia nuk buron nga bëmat, por nga e përditshmja dhe nga vetvetja, nga përjetimet intime. Idetë e unit lirik lidhen me kohën universale, si kohë e njeriut. Poetë që dolën nga vitet '70 si: Faslli Haliti, Natasha Lako, Sadik Bejko, Betim Muço, Moikom Zeqo, Spiro Dede, F. Çakërri, Petrit Çekrezi, Vojsava Musta, Zhuliana Jorganxhi, Ndoc Papleka, Gj. Beci, Llambro Ruci, etj. u prirën drejt lirizmit duke e larguar poezinë me trajtimet e gjinisë së poemës. Kështu, përgjithësisht poema, nuk pati më atë vëmendje prej krijuesve dhe kjo lidhet edhe me aspektin psikologjik dhe dëshirën e tyre, për t'u vetëperceptuar, për t'u bërë më normalë, më jetësorë, më të natyrshëm mes dilemave njerëzore, mungesave njerëzore, ndjesive të fshehta njerëzore si: ankthi, shpresa, frika, padurimi, shqetësimi, mes të cilave poeti e zbulon vetveten. Poemat e shkruara përgjithësisht patën karakteristike meditimin dhe

² M. Zeqo, *Tek unë*, "Zëri i rinisë", 15.03.1972, f. 3.

³ Që nga viti '75 e këtej, vihet re tendenca për t'u larguar poemës sidomos asaj të temës së madhe. Kritika e ngriti si problem të jetës së poezisë, por pati nga ata kritikë të cilët e panë si diçka normale të rrugës së zhvillimit të poezisë shqipe. P.sh. M. Xhaxhiu tek vep. e tij "Kritikë dhe studime" (Tiranë 1975, f. 19) shprehej: *Fakti që në poezi kanë dalë dhe po dalin probleme gjithnjë të reja e më të shumta me gjinitë e tjera tregon vitalitetin e saj. Poezia është esencë, është sentencë, është sintezë e mendimit fiklozofik dhe e gjithë artit të fjalës. Dhe nuk duhet absolutizuar mendimi i shprehur ca kohë më parë se është kjo, apo ajo gjini që tregon pjekurinë e letërsisë. Ka shumë shembëlla në letërsinë botërore që tregojnë se një gjini letrare merr një zhvillim më të madh në krahasim me gjinitë e tjera në kushte të veçanta historike.*

“Pse poetët nuk e shkruajnë më poemën?”, aspekte që kanë të bëjnë...

probleme të jetës, por një pjesë e krijimeve në këtë gjini, eci akoma në rrugën e poemave militante, duke përfaqësuar modele të varfra, ndonëse jo pak herë të vlerësuara nga kritika, e cila e gjykonte zhvillimin e kësaj gjinie në një rrugë të mirë, duke forcuar shtratin e saj epik, me më shumë realizëm se përpara duke iu shmangur abstragimeve të thata⁴.

Poemat që u shkruan në këto vite ('70) si: “Prishtina”, “Ringjallja”, “Shënime për brezin tim”, “Përse mendohen këto male”, “Devoll Devoll”, “Baballarët”, “Alarme të përgjakura”, “Drejt qindra shekujsh shkojmë” ('74) etj., u cilësuan me *prirje të shëndosha* dhe të pastruara nga *ndonjë shenjë hermetizmi*.⁵ Vepra të tjera si “Monolog partizan” (S. Buçpapaj), “Pa malet nuk ka maja” (L. Qafzezi), poema nën frymën e plenumit IV të KQ, sollën frymën e heroizmit masiv, dhe u panë nga kritika si modele që karakterizohen nga përgjithësimet e mëdha dhe lidhja organike e realitetit me të ardhmen.

Poezia e viteve '80, ishte poezia i cila synoi të shohë në mënyrë subjektive brenda shpirtit njerëzor duke u bërë më personale. Do të mjaftonte ta argumentonim këtë me botën poetike që krijuan N. Papleka, N. Gjetja, P. Zogaj, R. Marku etj. Pjesë të caktuara të krijimtarisë të tyre të viteve '80, s'qenë gjë tjetër veçse, gamë e gjerë përjetimesh dhe përpjekjesh për të zbërthyer strukturën e ndërlikuar njerëzore larg heroizmit, në mënyrë intime dhe miqësore, gazmore dhe shpotitëse e cila u has edhe në poezinë e të rinjve, por më së shumti në poezinë e talenteve të afirmuar tashmë. Heroi lirik i poetëve të viteve '80, lufton për jetën, parashikon të ardhmen, vendoset me marrëdhënie me kohën, me botën, me njerëzit e afërt dhe me veten, me ndershmërinë dhe urrejtjen, me çiltërsinë, me lakminë, burokracinë, servilizmin, apatinë, ftohtësinë, mefshtësinë

⁴ M. Xhaxhiu, *Kritikë dhe studime*, Tiranë, 1975, f. 120.

⁵ D. Shaplo, *Vështrime kritiko-letrare*, Tiranë, 1978, f. 113; *Me poemën “Drejt qindra shekujsh shkojmë”, (...) Arapi ashtu sikur, edhe në krijime të tjera i largohet vargjeve hermetike që patën depërtuar në ndonjë krijim të tij të mëparshëm. Kjo prirje e shëndoshë u duke te një cikël poezishë që pat botuar te “Nëntori” pas plenumit të IV, me vargje për dëshmorët me motive të mbështetura në krijimtarinë popullore.*

njerëzore, guxim, kureshtjen, etj. Shumë cilësi të poezisë erdhën si rrezatim i brezit të mëparshëm Kadare, Agolli, Arapi dhe u pasuruan e fituan larmi, por në dallim nga paraardhësit, **poetët e viteve '80, e lëvruan më pak poemën**, fakt që u ngrit si problematikë e jetës së poezisë së këtyre viteve. Nisur nga të dhënat për botimet e poemave, u vu re rënie e numrit të botimeve në këtë gjini, ndonëse jo në përcaktimet alarmante të kritikës, e cila shihnin tashmë largimin nga e madhërishmja që nxiste frymëzimin e poezisë së viteve '60.⁶ Në shkrime gjykohej se epopeja, apo poema ishte mënjeluar⁷. Në kërkesën e vazhdueshme për lëvrimin e gjinisë së poemës, po aq sa të temës së madhe, dallohet qartë *meraku* për shkëputjen e lidhjeve me traditën, raporti i së cilës me novatorizmin cilësohej si gjithmonë i hapur. Por mbi të gjitha, poema e viteve '80 shqoi së pari për dëshirën e madhe të poetëve për diçka ndryshe, diçka të re, kjo vinte edhe nga kontaktet që kishin një pjesë e tyre me letërsinë botërore. Ky pasion që vihej re dukshëm, nuk përqendrohej vetëm tek forma, por edhe te një frymë e re meditative. Këta poetë të viteve '80, nuk përpiqeshin të shkëpusnin lëndën letrare nga forma në shërbim të ideologjizimit, por t'i përshtatnin një forme të re, një lëndë të re, një substancë të re letrare, larg ideologjikes. Karakteri emancipues i këtyre poemave ashtu sikurse gjithë poezisë vinte në rritje të vazhdueshme, pavarësisht krijimeve të vulgarizuar në ideologji që botoheshin ende.

– Këto poema, qoftë edhe me dobësi, pasqyronin një frymë risi, një frymë intelektualiste që shfaqej së pari tek poetët, të cilët kishin tashmë një status dhe ishin bërë të njohur për talentin e tyre. Përsosja e stilit ndër poetë të tillë si M. Zeqo, B. Londo, N. Gjetja, P. Zogaj, provokoi kritikën e cila nënkuptonte dëshirën e madhe për t'iu shpëtuar vargjeve të estetikës së realizmit socialist. Fryma e lehtë, po aq sa e thellë, intime, fluksi i qetë i ndjesive që tentonin të

⁶ Kritiku A. Kallulli vinte re se heronjtë e aktualitetit nuk kishin më përmasat e heronhve të karaktereve të luftës (*Mbi koceptimin dhe mishërimin artistik të heroit*, "Drita", 29.05.1983), D. Shaplllo theksonte se poema nuk kishte shënuar ndonjë sukses përgjithësimesh (*Poezia nëpër kohë*, 1990, f. 80). Të njëjtin mendim me ta ndante edhe Ll. Siliqi (*Poema dhe kritika për të*, "Drita", 6.03.1986).

⁷ I. Yzeiri, *Kush flet për poezinë*, "Drita", 4.05.1986.

“Pse poetët nuk e shkruajnë më poemën?”, aspekte që kanë të bëjnë...

çliroheshin, ishte shumë larg modelit të ligjërimit të heronjve, duke iu bashkangjitur poezisë së të thjeshtës jetësore. Kështu, këto poema paraqitën një tip njerëzor, i cili ishte pothuaj një antihero. (...) *se ajo që i ikte botës / Njerëzorja, e thjeshta / Ajo që s’e mbanin dot shtetet, qeveritë, / Vinte dhe strehohej tek ne / pikë-pikë*⁸. Vargu i shtruar nën shembullin e Uitmanit, apo vargu që rrëskiste drejt prozës, metafizika e brendisë, herë-herë e zhvilluar si një monologim, i dha dorë kësaj poezie antiheroike, apo antiheroizmit në përgjithësi. Uni lirik i këtyre krijimeve s’kishte asgjë prej heroi, situatat poetike të tipit monolog ishin të zymta, shpesh me detaje të errëta, të trishta, pa gjallërinë e kërkuar. Kjo atmosferë arrihej mes mjeteve specifike. Poetët, kishin kuptuar se militarizmi e kishte cunuar dhe tëhuajtëzuar poezinë nga natyra e saj, ku frymëzimi nuk ishte i vërtetë. E megjithatë, ky realitet shkrimor i gjinisë së poemës (kemi parasysh këtu shqetësimin e kritikës për numrin e vogël të poemave) nuk meriton kaq shumë vëmendje. Problemi nuk qëndron aq tek numri i poemave që shkruhen, por cilësisë së tyre dhe nga ana tjetër ajo që vihet re pa mëdyshje, është se kjo gjini nuk preferohej me as nga autorë të njohur të kohës. Dy-tre pena, lëvrojnë pa cilësi poemën ku motivet e luftës zënë vend kryesor, ndërsa poetët e tjerë janë drejtuar nga poezia intime e vetëperceptimit dhe eksperimentojnë me poezinë e gjatë të fragmentuar.

Tashmë, gama e problemeve që shtronte koha për t’u zgjidhur, pothuaj e pamundësonte trajtimin mes toneve epike dhe poemës si gjini e gjatë.

Por, ndonëse lënia në hije e kësaj gjinie është diçka e evidente, dhe prirja drejt unit dhe raporteve të tij me realitetin sipas një linje metafizike po bëhej e kapshme, në kumtesat e konferencave për problemet e letërsisë pohohej kërkesa e vazhdueshme ndaj lëvrimit të poemës. Në periodikë botoheshin artikuj problemorë ku poetëve të kohës u jepej si shembull; Naimi, Migjeni, Noli, Lasgushi, nga tradita dhe Siliqi, Agolli⁹, Kadareja, Arapi nga ajo që është bërë

⁸ R. Marku, *Udhëtim për në vendin e gjërave që njohim*, Tiranë 1989, f. 143.

⁹ R. Brahimi, “Drita” 9.06.1985, “*Udhëtojt i menduar*”-Takim i ri me një poet të njohur.

zakon të quhet poezi e viteve '60. Ky ballafaqim vlerash ra në sy edhe në studimet që prinin lëndën e përmbledhjeve kritike të R. Brahimit, I. Nelajt, Iskra Thomës etj., madje deri në vitet '90 kritiku D. Shaplllo e prezantoi si problematikë lëvrimin e pakët të kësaj gjinie, duke kërkuar lëvrimin e saj në modelin tradicional narrativ¹⁰.

– Duke kritikuar Arapin për kapërcime të papritura e të pa përligjura në arkitekturën e poemës, madje, duke mos kursyer edhe D. Agollin për trajtim më të gjerë të motiveve kaluar shkurt, mohohej modelin i poemës së fragmentarizuar, gjë që u cilësua nga shkrimtarët si një fokusim *me parametrat e viteve '60*¹¹. Përpos të tjerash, shkrimet kritike tërhiqnin vëmendjen drejt folklorit¹², model të cilit poezia i ishte larguar dukshëm. Në anakronizëm, sillej shembulli i poemës së tipit baladë, përmendej akoma “Epopoja e ballit kombëtar”, si *gur themeltar që nuk lëkundet me kalimin e viteve*¹³, apo poemat epiko-lirike, “Prishtina”, “Ashtu Myzeqe”, “Kënga e partizanit Benko”, “Heronjtë e Vigut” Myzeqe” etj. Siç shihet, kritika ngulmon më së shumti në narracionin poetik, në trajtime të motiveve të luftës, apo të përditshmërisë, por jo në shkrimin e poemave në frymë moderne ku heroi lirik është qendra ku nis dhe zhvillohet problematika e shqetësimi poetik.

Nga fundi i viteve '80, tashmë prirja drejt një poeme ndryshe është e dukshme. Kjo u pohua edhe nga kritika, e cila përgjithësisht e pranoi strukturën e moderuar të saj si një ndryshim, nën shenjën e evoluimit të kësaj gjinie, ashtu sikurse edhe gjithë poezisë në përgjithësi¹⁴. Megjithatë, lëvrimi i poemës u trajtua nga kritika si një

¹⁰ D. Shaplllo, *Poezia nëpër kohë*, “N. Frashëri”, Tiranë, 1990, f. 74-77; *Mënyrat e shprehjes kanë shkaqet e lindjes së tyre dhe të drejtën e lëvrimin, por fakte janë kokëforta dhe mund të themi se ka afro 30 vjet që tek ne nuk është shkruar ndonjë poemë ku narracioni të zejë vendin kryesor.*

¹¹ “Drita”, 22 shkurt, 1987, *Koha kërkon poemën, ndërsa ajo mungon.*

¹² “Drita”, 5.09.1982, R. Vozga, *Gjerësia e marrëdhënieve të poezisë me krijimtarinë poetike popullore.*

¹³ D. Shaplllo, *Poezia nëpër kohë*, “N. Frashëri”, Tiranë 1990, f. 78.

¹⁴ R. Brahimi, rubrika: “Në rrugën e zhvillimit dhe të pasurimit të poezisë”, *Me mendim e qëllim të qartë*, “Drita”, 22.01.1989, *Prirja e përgjithshme është synimi drejt një poezie sintezë e cila përherë e më me sukses po i kundërvihet manisë së dikurshme për inflacion të fllaës, e mbingarkesë figurative. Poezia e*

“Pse poetët nuk e shkruajnë më poemën?”, aspekte që kanë të bëjnë...

lloj matje me mjeshtërinë letrare të poetit, pra, si një aspekt dëshmuar për zotësinë poetike në formësim dhe në shprehësi letrare, si një kulm poetik, i cili nuk mund të prekej nga të gjithë, gjykim që u kundërshtua nga poetët (N. Gjetja, N. Papleka, R. Marku), që mendonin se *poema nuk ishte më një kërkesë e rëndësishme e kohës*¹⁵, dhe veç të tjerash trajtimi i saj kishte të bënte, jo aq me mungesën, se sa me praninë e stileve, parapëlqimeve poetike dhe diversitetin e kumtit poetik, prandaj fakti duhej pranuar si një rrethanë e natyrshme e zhvillimit letrar; poema lëvrohej, por impenjimi i saj nuk ishte ai i 25-vjetëve më parë. Kjo gjini jo vetëm e kishte humbur tashmë fuqinë dhe magjinë dy dekadave më parë, por mbi të gjitha dallonte nga poemat e viteve '60, me një arkitekturë ku vargjet thyheshin duke ndikuar deri grafikisht mbi emocionalitetin e lexuesit, pa harruar këtu edhe praninë e fluksit e përfytyrimeve dhe meditimeve që sillnin poetët në të. Poema “Fytyrë burri” e B. Mustafajit për shembull, veç vargut të thyer, dallonte me tundimin e poetit për të përshkruar qenien, apo mundimin e njeriut modern. Optimizmi që shfaqet, herë herë mund të kuptohet edhe si një mburojë e rrejshme e ankthit ekzistencial që përjeton njeriu bashkëkohor i socializmit. Shumëkuptimësia e kësaj poeme, u komentua si lakonizëm¹⁶. Në lidhje me vijimësisë së traditës së shkrimit të poemës, u shfaqën mendime se poema që shkruhej duhet të ishte një format i denjë poetik, i cili do të mund t'i qëndronte përballë *formës etalon* të poemës së viteve '60, madje duke e cilësuar fragmentizmin që u vu re si tendencë, një dukuri varfëruese. Në fakt, këto debate, dëshmojnë përpjekjen e vazhdueshme për shkapëputje nga modele të vlerësuara si vijimësi lidhjesh me traditën.

Ndërkohë që u bënë përpjekje në këtë gjini me tituj si: *Fjalët e borës së re* (N. Papleka)¹⁷, ku optimizmi, tonet lirike, intime erotike

sotme nuk është aq kushtruese sa ajo e dekadave të mëparshme, por as mendimi në të nuk kanë më pak thellësi e forcë tërheqëse...

¹⁵ “Drita”, 22.02.1987, *Koha kërkon poemën, ndërsa poemën, ndërsa ajo mungon.*

¹⁶ N. Papleka, “Drita”, 17.06.1984, f. 5, *Pasurime të mëtejshme poetike.*

¹⁷ “Zëri i rinisë”, 10.12.1983.

dhe sociale, përzihen me këngën për punëtorët e sakrificat e tyre të mëdha. *Jeta e një dite* (Xh. Spahiu), mes lirismit i thur himn punës së punëtorëve dhe detajeve nga stina e pranverës¹⁸, poema *Krijo bukurinë*¹⁹ (K. Papa), është një shumësi detajesh lirike intime përmbledhur në 17 pjesë, ku përmes rrekjes së unit lirik për të përfshirë figurën e dashur në lidhjet e tij me tokën, ndjehet si frymë ndikimi i fortë nga poezia e Agollit dhe herë-herë poetëve të veriut: B. Mustafaj, N. Gjetja, e P. Zogaj, “Epitafi i 7 ëndrrave”, poemë e B. Londos botuar në “Drita” ’87²⁰, ishte një nga poemat e cila solli për lexuesin jo vetëm tendencën për t’u larguar nga tema e madhe, por edhe mjeshtërinë e vjershërimit dhe modelin sfidues strukturor të fragmentizuar të poezisë së gjatë të viteve ‘80. Poema ndërtohet sipas parimit lirik dhe struktura e saj tregimtare, organizohet në 7 pjesë: *Prolog, Vrasja e dashurisë, Intermexo një, Vrasja e shokut, Vrasja e Fytyrës, Intermexo tre, Vrasja e pasioneve, Intermexo pesë, Vrasja e vendlindjes, Intermexo gjashtë, Vrasja e vdekjes, Intermexo shtatë, Vetëvrasja, Epilog*. Vargu thyhet për t’i dhënë rëndësi një fjale të vetme (Vrasja e..), e cila është njëkohësisht konflikti i poemës, konflikti i unit lirik dhe botës së tij morale. Fjala “vdekje”, nënkupton qëndrimin individualist, i cili eliminon fijet e sinqerta në jetën njerëzore duke shkuar deri tek vetëvrasja. Poeti vë në qendër numrin shtatë. Ka shumë gjasa krijimin e botës nga Zoti; shtatë ëndrra, shtatë ditët e krijimit të botës nga Zoti, prej dashurisë për njeriun. Poeti ç’bën në shtatë ditë? Ç’botë krijon ai? Bota e poemës është ajo e njeriut të ri dhe botës së re komuniste ku ai gjallon, mes parimeve morale. Uni lirik bëhet zëdhënës i kësaj bote, ku dashuria për kohën dhe atdheun zë vendin kryesor. Poema ka natyrë dinamike; rreshtohen detaje nga jeta dhe natyra në lëvizje. Mbyllja e poemës, s’është gjë tjetër veçse një *deux es machina* – një zgjidhje e politizuar që bën autori për të shpëtuar veprën, ndjenjat e krenarisë për kohën në të cilën jeton uni lirik. Edhe pse kjo poemë i thur lavde epokës së komunizmit po ta shohësh nga ana e sendërtimit të lëndës

¹⁸ “Drita”, 15.04.1984.

¹⁹ “Drita”, 12.04.1987.

²⁰ “Drita”, 12.07.1987.

“Pse poetët nuk e shkruajnë më poemën?”, aspekte që kanë të bëjnë...

letrare dhe frymëzimit, mjeshtërisë së vargëzimit, edhe sot mund të bëjë jetë aktive letrare duke dalluar thellësisht nga poemat: *Ti ishe komunist, Faleminderit det, Vajzë e vogël me jetë të madhe*, të cilat ishin pjesë e vëllimit poetik *Emrin e ka dashuri* (1985), kur poema të tilla si *Balada e arkitektit*²¹, *Kasollja e Galigatit, Nesër*²², përbëjnë një dështim të plotë.

B. Londo ishte dhe poeti më i suksesshëm në shkrimin e kësaj gjinie gjatë viteve '80. Pavarësisht kohës dhe konformizmit, idealeve estetike dhe shpëtimit të tyre mes kamuflimit në trajtesa të heronjve të luftës NÇL, poemat e tij e përjashtojnë strukturën klasike dhe vargun e matur e ndjejnë si një prangim. Këto tekste poetike ngërthejnë në vetvete sprovën dhe arritjen, eksperimentimin dhe rrokjen e domethënies të qarta dhe të errëta, duke mbetur kështu sa në hije aq edhe në dritë vlerash. Poema *Thirrjet e gjakut*²³ (e cila i kushtohet partizanit 13 vjeçar që vritet në luftë) mund të shihet si një lloj kredoje për një estetikë të re që shpallet në modelin e poemës mozaik.

Mirë pra / Le t'i flasë gjaku-gjakut / ashtu siç di gjaku / pa poza / pa fjalë, / ulu / tani / në vargun

/ tim / Po si t'ia bëj me kritikët mediokër, të rreptë? / Ç'është kjo poemë mozaik?- i ndjej si bërtasin

Pse s'shkruan / Si / Në / Vitet / Gjashtëdhjetë? / Si tu përgjigjem historianëve pedantë?

Në një tendencë të tillë, ndonëse në formë më të zbutur vjen edhe poema *Në një ditë njerëzore* që merr spunto nga thënia e Borgesit *Brenda një dite njerëzore janë të gjitha ditët*.²⁴ Poema ndërtohet sipas parimit lirik dhe ndahet në 15 pjesë, të cilat si formë artistike marrin vlerë mes pikave referenciale dashuria si bosht, kuptim, motiv i kohëve. Dashuria si pjesë e tragjikes që vjen nga ndalesat dhe muret, dhe së fundi dashuria që merr trajta femërore të një gruaje që ecën me një çantë të vogël në krahë. Por, ndërsa

²¹ “Drita”, 22.04.1984, *Balada e arkitektit*, K. Petriti.

²² H. Milloshi, *Nesër* (“Drita”, 2.11.1986), H. Milloshi, *Kasollja e Galigatit* (“Drita” 26.08.1985).

²³ “Drita”, 8.04.1989.

²⁴ “Drita”, 16.07.1989.

kërkohej lëvrimi me ngulm i poemës, botohen përmbledhje më poezi të ndara në cikle, dukuri e cila u komentua si formë e lëvrimit të poemës²⁵, apo lëvrime të tipit baladesk, ku nuk mungojnë komentet psikologjike dhe referencat misterioze, ku kuptimi realizohet me ndihmën e veprimit të drejtpërdrejtë, apo lidhjeve të fshehura me kontekstin e ngjarjeve. Dekori baladesk gjeti shfaqje tek poezia e poetit Xh. Spahiu.

*I qan të tërë me rradhë / të rënë përmbys a në brinjë / ata me kokë të prerë / a me sytë nga qielli i hirtë*²⁶. Vargjet të tilla u bënë dëshmi e trajtimit me ndjeshmëri e origjinalitet të lëndës folklorike, duke përcjellë emocionin e një atmosfere imagjinare baladeske, ku figura e Ajkunës mban gjurma autentike të mallkimit dhe uratës (lidhur drejtpërdrejtë me vdekjen dhe rilindjen mes pjellorisë). Pas kujës ngjethëse, veprimi i të përmendurit të vetes, është i prekshëm sidomos në sferën morale shqiptare. Qëndresa, si vlerë shpirtërore sipërore, në kontekstin individual, zhvendoset në kuptimin e mbijetesës kombëtare, që kurrë nuk e pranoi fundin.

Së fundmi, poema në vetvete si lëvrim, si formë poetike nënkupton traditën. Kritika shtetërore e kapur fort pas saj dhe e kërkoi në vazhdimësi me ngulm. Tradita e poemës është tradita e temës së madhe, tema e qëndresës, apo e ndryshimeve të thella. Numri i pakët i poemave që po shkruhej dëshmonte se kjo traditë po thyhej. Në një nga intervistat e tij Kadare thotë se *e gjithë tradita letrare është një lloj skllavërie, por pikërisht në poezi ndjehet më shumë. Mund të kesh iluzionin se iu shmange, por nuk i shmanges dot. Ankthi i së shkuarës...ndjehesh rob i këtij brumi poetik të përjetshëm e të ardhur, dhe është shumë e vështirë të krijosh një brumë të ri...*²⁷

²⁵“Drita” 15.05.1988, *Motivi kryesor dashuria ndaj njeriut, përmbledhje me poezi të zgjedhura të N. Gjetjes*, R. Brahimi, 84 krijime të ndara në 6 cikle (...) Edhe vetë përmbledhjet në cikle janë një trajtë e lëvrimit të poemës.

²⁶ *Elegji e thinjur*, Xh. Spahiu, “Drita”, 17.06.1984.

²⁷ Eric Faye, *Tri biseda me Kdarenë*, Onufri 2007, f 40.